



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Nikolin Staka, Ervin Bushati, Anastas Angjeli dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Artemis Dralo (Malo), Artur Roshi, Vullnet Sinaj dhe Edlira Hyseni.

Të ftuar:

Nikolla Lera – përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Doriana Toro - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi - përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Përshëndetje!

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e dy çështjeve. Si çështje e parë është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”. Relatore është zonja Evis Kushi.

Së dyti, shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”.

Relator i këtij projektligji është zoti Ervin Bushati.

Për mbrojtjen e marrëveshjeve nga Ministria e Financave kanë ardhur në komision zoti Niko Lera, zonja Dorian Toro dhe zonja Brikena Jazxhi. Meqenëse, zoti Niko, vlerëson më shumë punët e tjera sesa këtë punë, duke e lënë komisionin të presë 15 minuta, herë tjetër zoti Niko, as ti, as ministri, as zëvendësministri apo kë keni atje në qoftë se vini me vonesë, do ta anulojmë mbledhjen dhe do ta kalojmë vendimin për muajin e ardhshëm, sipas rregulloreve që ka Kuvendi. Në këtë pikë ju tërheq vëmendjen.

Fillojmë me shqyrtimin e marrëveshjes “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Zoti Niko, keni ndonjë gjë për të thënë?

Nikolla Lera – Së pari, dua t’ju kërkoj ndjesë për vonesën, gjë që nuk do të përsëritet më, por ishte për shkaqe shumë madhore.

Anastas Angjeli – Nuk ka shkaqe më të mëdha se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Këtë gjë ta harrosh ti, ta harroj qeveria dhe kushdo...

Nikolla Lera - Keni shumë të drejtë.

Anastas Angjeli – Nuk mund t’ju presin deputetët ju.

Nikolla Lera – Lidhur me marrëveshjen për eliminimin e dyfishtë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, është një marrëveshje në kuadrin e të gjitha marrëveshjeve që Republika e Shqipërisë ka lidhur dhe synon të lidhë me vendet e treta. Është një marrëveshje standarde dhe Shqipëria ka lidhur rreth 45 të tilla. Kjo marrëveshje synon të nxisë investimet reciproke dhe këto lloj marrëveshjesh konsiderohen si pararendëse të investimeve apo të fluksit të investimeve ndërmjet dy vendeve. Negocimi ka filluar që në vitin 2010-2011 dhe është miratuar me vendim qeverie në vitin 2012, pra ka një periudhë shumë të gjatë. Është nënshkruar nga Ministria e Financave para disa muajsh, më saktë në shkurt të vitit 2019 në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe ne synojmë që nëpërmjet eliminimit të tatimit të dyfishtë apo ndarjes së të drejtës së taksimit për të ardhurat dhe kapitalin të krijojmë garancitë dhe stimujt e nevojshëm, për investitorët potencialë në mënyrë që ata të ndihen të sigurt në investimet e tyre në Republikën e Shqipërisë ashtu, sikurse do të ketë raste edhe për investime të rezidentëve shqiptarë në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Faleminderit!

Evis Kushi – Projektligji që po diskutojmë sot vjen si propozim i Këshillit të Ministrave, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton në cilësinë e komisionit përgjegjës. Qëllimi i projektligjit, siç e thatë edhe ju, ka të bëjë me shmangien e tatimit të dyfishë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat, pra ratifikon marrëveshjen që lidhet midis dy vendeve, Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Përmes kësaj marrëveshjeje shmanget tatimi i dyfishtë, që do të thotë se shmanget detyrimi që e njëjta e ardhur të paguhet dy herë në të dyja vendet, për të gjithë ata persona fizikë apo juridikë që ose kanë biznes në të dyja vendet, ose një njërin vend, pra janë rezidentë në njërin vend dhe përfitojnë të ardhura edhe nga vendi tjetër.

Marrëveshje të tilla janë lidhur me 41 vende, që janë jo vetëm në rajon, por edhe në vende të tjera të largëta, duke filluar me Maqedoninë e Veriut, Kosovën, Bosnjën, Serbinë, me vendet e Bashkimit Europian, siç janë Greqia, Italia, Gjermania, Polonia, Rumania, si dhe me vende të largëta si Rusia, Koreja e Jugut apo edhe me vende të rajonit të Arabisë Saudite, siç janë Katari apo Emiratet e Bashkuar Arabe. Marrëveshje të tilla janë shumë të rëndësishme, prandaj edhe këtë marrëveshje e konsiderojmë të tillë, sepse stimulon marrëdhëniet ekonomike, tregtare

midis dy vendeve, si dhe rritjen dhe nxitjen e kompanive shumëkombëshe, por nxit edhe lëvizjen e lirë të njerëzve, të mallrave dhe të kapitalit.

Në marrëveshje janë të specifikuara saktë se cilat janë llojet e tatimeve që përfshihen në këtë marrëveshje, pra që shmangen nga detyrimi dhe në rastin e Shqipërisë kemi tatimin mbi të ardhurat, tatimin mbi aktivitetin e biznesit të vogël dhe tatimin mbi pasuritë.

Duke e rëndësuar si të rëndësishme këtë marrëveshje u sugjeroj kolegëve ta votojnë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Kushi!

Kush ka pyetje? Nuk ka.

A ka ndonjë diskutim? Nuk ka.

Kam unë diçka.

Zoti Niko, para dy vjetësh ju kemi kërkuar në Komisionin e Ekonomisë të filloni të negocioni për të realizuar një marrëveshje të eliminimit të tatimit të dyfishtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Që nga ajo kohë e deri tani nuk na keni dhënë asnjë përgjigje. 45 marrëveshjet që Shqipëria ka apo 41, aq sa keni shkruar në relacion, me shtetet që përmendni, janë shumë të rëndësishme, edhe pse në ndonjërin prej tyre, siç mund të jetë marrëveshja me Islandën, në të cilën mund të mos ketë asnjë shqiptar investitor në Islandë apo asnjë investim të Islandës në Shqipëri, për shkak të marrëveshjeve që kemi, për shkak të vullnetit që Shqipëria ka për të pasur marrëveshje me të gjitha vendet, veçanërisht me vendet e Bashkimit Europian, ne i kemi realizuar këto marrëveshje.

Pyetja që unë kam është: a keni ndonjë përgjigje deri më sot sa u takon tentativave që ju keni bërë për të realizuar një marrëveshje të eliminimit të taksave të dyfishta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Ne në komision kemi vlerësuar që Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë partneri më strategjik i Shqipërisë, kanë qenë, mbeten dhe janë shumë të mirëpritura investimet amerikane në Shqipëri. Pa dyshim që kjo është një marrëveshje shumë e domosdoshme që ata të jenë të pranishëm.

Nga ana tjetër një marrëveshje e tillë do t'u shërbente mbi 100 000 shqiptarëve që banojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sa i përket eliminimit të taksave të dyfishta. Unë e kuptoj se të realizohet një marrëveshje duhen dy palë dhe vullneti i të dyja palëve, por nuk e di se sa shteruese kanë qenë përpjekjet tuaja për ta realizuar ose të paktën për të filluar negocimin e një marrëveshjeje të tillë. Faleminderit!

Nikolla Lera – Faleminderit për pyetjen, zoti Angjeli!

Dëshira për të hyrë në negociata me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuptimin e negocimit të marrëveshjes së eliminimit të tatimit të dyfishtë ka qenë e vazhdueshme dhe e hershme nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ne kemi kërkuar nga përfaqësia jonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga faktorë të tjerë që mund të lobonin në këtë drejtim që të që të realizohej një proces i tillë. Kemi qenë në Uashington dhe kemi diskutuar me zyrtarë të departamentit të thesarit edhe në tetor të vitit 2016 edhe në vitin 2017. Nëpërmjet mbështetjes dhe argumentimit të Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe të faktorëve të tjerë, që mund të nxisin në këtë proces, kemi kërkuar që ne të fillojmë negocimin me departamentin e thesarit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Natyrisht që Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë fuqia më e madhe globale në botë, ata kanë probleme me vende të tjera, me të cilët kanë pjesën dërmuese të tregtisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përmenda këtë, sepse në diskutime me zyrtarë të departamentit të thesarit na u vendos si prioritet dhe si periudhë shumë e zënë negociatat që ata zhvillonin me Japoninë dhe shtetet të tjera, ndërkohë thanë që për momentin mjafton marrëveshja shumëpalëshe e shkëmbimit të informacionit. Pra, ne jemi pjesë e kuadrit të marrëveshjes së shkëmbimit të informacionit dhe nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ne mund të shkëmbejmë informacion për çdo subjekt dhe entitet juridik apo individ që operon në Shqipëri apo në SHBA. Pra, dëshira jonë ka qenë, është dhe do të jetë maksimale për të filluar këto negociata.

Siç ju sqarova, departamenti i thesarit ka pasur prioritete me shtete, me të cilat zhvillon volumn më të madh tregtar dhe ndoshta e ka lënë për një periudhë tjetër negocimin e marrëveshjes me Shqipërinë. Ne kemi insistuar dhe presim çdo suport, në mënyrë që të mund të realizojmë kontakte dhe të fillojmë negocimin me ta.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Ne gjykojmë se përpjekjet tuaja duhet të jenë maksimale dhe të vazhdueshme në funksion të fillimit të negociatave për një marrëveshje të eliminimit të tatimit të dyfishtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një portë që të hapet për të tërhequr sa më shumë investime amerikane në vendin tonë. Pa dyshim është shumë e domosdoshme që këto përpjekje të jenë të vazhdueshme nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë për Europën dhe Punët

e Jashtme. Dua t'ju ftoj që për një javë të na jepni një informacion të detajuar me shkrim drejtuar Komisionit të Ekonomisë për ecurinë e kësaj pune dhe këtyre përpjekjeve.

Faleminderit!

Kalojmë në votim.

Ilir Bejtja – Përshëndetje!

Marrëveshja që ne sjellim sot ka kaluar më parë si marrëveshje qeveritare, tani kalon ratifikimi i marrëveshjes së huasë, i cili lidhet me financimin e sektorit të energjisë nga një kontratë huaje nga banka gjermane KfW për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, për përmirësimin e nënstacioneve në disa zona të përcaktuara dhe për instalimin pilot të një sistemi të automatizuar kontrolli për shpërndarjen e energjisë elektrike në korridorin Tiranë-Durrës, i cili është edhe konsumatori më i madh i të gjithë energjisë për vendin. Kjo marrëveshje konsiston në dy programe kryesore, i pari është ai i shpërndarjes dhe i dyti është ai i sistemit të automatizuar të kontrollit. Të dyja synojnë reduktimin e humbjeve dhe rritjen e cilësisë së furnizimit. 30 milionë euro hua janë të shoqëruara me një grant prej 2 milionë eurosh, që do të përdoren për asistencë teknike për realizimin e projekteve. Ky grant është i disbursueshëm në tri vjet, kostot e interesave janë të njëjtat siç i kemi pasur deri tani në marrëveshjet e marra në kuadrin e akordit ndërqeveritar me qeverinë gjermane, i cili ka filluar që në vitin 2009. Kjo marrëveshje është iniciuar në vitin 2016 dhe që nga ky vit nga Ministria e Financave është vendosur kusht që disbursimi i saj dhe mbulimi në tavanet buxhetore brenda tavaneve të PBA-së dhe atyre vjetore të jetë i lidhur me treguesit e performancës së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe rritjes së eficiencës së tij, që do të thotë rritje arkëtimesh dhe ulje humbjesh. Ne i kemi arritur këta tregues, ashtu siç kanë qenë të parashikuar në planin e konsolidimit financiar të sektorit dhe jemi të kualifikueshëm për ta përfituar këtë financim. Kjo lidhet edhe me situatën krejt të ndryshuar të vlerësimit të auditëve për sektorin e shpërndarjes, të cilët kanë dhënë një vlerësim kalueshëm me konsiderata për vitin 2017 dhe po kështu pritet i njëjti vlerësim për vitin 2018, akoma më i përmirësuar, që do të thotë se sistemi është duke ecur në rrugën e duhur dhe është duke u bërë i pavarur me të ardhurat e tij për të mbuluar të gjitha financimet e mundshme në të gjitha nivelet. Kjo nuk i zgjidh të gjitha problemet, sepse i gjithë projekti i sistemit të automatizuar të kontrollit shkon rreth 55 milionë euro, por që me kalimin e kohës do të vazhdojë edhe me paratë e OSHEE-së. Ne kemi parashikuar një program 3-vjeçar “Plani strategjik i zhvillimit të sektorit”, i cili është miratuar edhe me vendim qeverie, me rreth 7,75 miliardë lekë

investime në vit me të ardhurat e vetë OSHEE-së. Gjithsesi, në një moment të tillë, ku ne kemi ndaluar investimet për shkak edhe të situatës së vështirë hidrike, vjen shumë i nevojshëm për ne për të vazhduar me skemën e investimeve.

Anastas Angjeli- Faleminderit!

Fjala për zotin Bushati.

Ervin Bushati- Faleminderit!

Programi që do të financohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të ndihmojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve në rrejt, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë me furnizim me energji elektrike për konsumatorët. Ky program synon mbështetjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit elektroenergjitik, si një ndër sektorët prioritarë për zhvillimin e ekonomisë sonë.

Kostoja totale është 32 milionë euro. Kjo kosto do të financohet nga huaja e parashikuar në këtë marrëveshje prej 30 milionë eurosh, si dhe një grant prej 2 milionë eurosh, që do të përfitohet nëpërmjet një marrëveshjeje tjetër me KfW-në. Granti do të përdoret për financimin e masave të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit. Vlera e TVSH-së dhe koston lokale për këtë program do të mbulohet nga buxheti i OSHEE-së.

Norma e interesit është një normë fikse vjetore, e cila do të përcaktohet një ditë pas njoftimit të KfW-së se marrëveshja është bërë efektive. Tarifa e angazhimit është 0,25% mbi shumën e padisbursuar të kredisë; tarifa e menaxhimit është 1% mbi shumën e kredisë. Maturimi është 12 vjet, duke përfshirë periudhën prej 4 vjetësh pa pagesë principali. Kjo hua do t'i nënshkruhet OSHEE-së me të njëjtët terma dhe kushte financiare sipas kësaj marrëveshjeje.

Dua të falënderoj KfW-në dhe Republikën Federale të Gjermanisë, të cilët kanë investuar në mënyrë të vazhdueshme me mbi 1 miliard euro, sidomos në sistemin energjetik dhe atë të infrastrukturës. Kjo marrëveshje do të sigurojë financimin e nevojshëm për reduktimin e nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes; si dhe rritjen e cilësisë, efikasitetit dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorin shqiptar.

Ajo krijon kushte për ta çuar më përpara reformën në sektorin energjetik, si një ndër sektorët prioritarë të ekonomisë. Për këto arsye i propozoj komisionit votimin pro këtij projektligji.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Ka pyetje?

Urdhëroni!

Xhevit Bushaj – Faleminderit, drejtues i seancës!

Ju falënderoj për shpjegimet rreth kësaj aktmarrëveshjeje!

Unë kisha një pyetje në lidhje me kushtet e marrjes së kredisë, me disbursimin dhe me pagesën e principalit dhe të interesave.

Te periudha pauzë e 4 vjetëve të parë nuk do të paguhet as interes apo do të paguhet vetëm principal?

Brikena Jazxhi – Në periudhën që zgjat rreth 4 vjet, e cila quhet *grace period*, nuk paguhet principal i shumës, ndërsa interesi paguhet menjëherë pas disbursimit të kredisë.

Anastas Angjeli - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Kisha unë disa pyetje.

Pyetja e parë, lidhet me përcaktimin e interesit. Siç keni argumentuar edhe në relacion, keni vënë disa elemente, disa faktorë, të cilët arrijnë në përfundimin që interesi edhe pse është negociuar dhe është diskutuar, do të fiksohet me hyrjen 2 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes. Kjo është pyetja e parë. A mund të na thoni nëse këtë praktikë keni zbatuar gjithmonë me KfW-në, këtë praktikë keni zbatuar gjithmonë edhe me donatorët e tjerë dhe arsyen pse.

Kush e do fjalën?

Çfarë detyre keni dhe si quheni?

Brikena Jazxhi - Unë quhem Brikena Jazxhi dhe jam specialiste në Drejtorinë e Borxhit në Ministrinë e Financave.

Anastas Angjeli – Nuk ka drejtorë atje?

Brikena Jazxhi – Aktualisht, nuk kemi nivel drejtues në Drejtorinë e Borxhit.

Anastas Angjeli – Po. Nuk jua kërkoja juve këtë sqarim, por ia kërkoj Ministrisë së Financave.

Faleminderit, për sqarimin!

Unë pyeta nëse ka drejtor. Këtu jemi në Kuvend dhe niveli i përfaqësimit për miratimin e projektligjeve të tilla, fillon nga ministri, zëvendësministrat dhe drejtorët.

Falënderojmë zëvendësministrin, që ka ardhur sot në komision!

Mund të vijoni, Brikena!

Brikena Jazzhi – KfW-ja është një ndër kreditorët më të rëndësishëm për financimin e projekteve. Prej më se 10 vjetësh ne po operojmë në të njëjtën mënyrë. Përcaktimi i normës së interesit nuk mund të bëhet në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë. Kjo për shkak se sipas kushteve të kreditorit është e nevojshme që kredia të angazhohet për vendin që do ta marrë dhe më pas të përcaktohet norma e interesit.

Në kushtet kur bërja efektive e marrëveshjes kërkon dhe ratifikimin e saj nga parlamenti, gjë që krijon një diapazon kohor nga momenti i nënshkrimit, ishte kusht i kreditorit që mënyra e përcaktimit të normës së interesit të bëhet në këtë mënyrë pas bërjes efektive të kredisë, pra një ditë pasi ratifikohet marrëveshja, ne njoftojmë kreditorin dhe ai përcakton normën e interesit. Kjo është për kreditorët që e përcaktojnë normën e interesit në kredi, ndërsa për kreditorët që punojnë me norma variabël, ajo përcaktohet në marrëveshjen e kredisë se si do të jetë kjo normë që është Euribor me një marzh të caktuar ose jo. Kjo është për rastet, kur interesi është i fiksuar.

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Kam edhe një pyetje për ju, zoti zëvendësministër.

Ju thatë se kjo kredi, kjo mbështetje që i jepet sektorit energjetik është shumë e rëndësishme dhe vjen në një kohë shumë të përshtatshme për nevojat që ka sistemi energjetik shqiptar dhe aq më shumë për kushtet hidrike dhe për situatën e motit në Shqipëri. Përveç kësaj situate hidrike, sa i përshtatet kjo kredi gjendjes financiare të OSHEE-së?

Ilir Bejtja – Nëse flasim për gjendjen financiare, ne jemi brenda limiteve të parashikuara në programin ekonomik. I kemi stopuar investimet në mënyrë që të mos kemi asnjë tejkalim të kostove dhe të mos transmetojmë asgjë te konsumatori fundor. E rëndësishme për ne është që të kemi një bilanc të shëndetshëm, i cili të rezultojë pa humbje. Deri tani jemi në kontroll të tij. Ky është një vit i vështirë si 2 vjetët që kanë kaluar, ku ne kemi pasur importe ekseseve të energjisë elektrike. Në vitin 2017 gjatë gjithë vitit dhe në vitin 2018, në 6-mujorin e dytë. Pra, tejkalimi i blerjeve për mbulimin e nevojës për energji na ka detyruar të reduktojmë totalin e investimeve që kemi të planifikuar çdo vit. Prandaj thashë se kjo vjen në një moment shumë të rëndësishëm për ne, kur ne nuk prekim shifrën tonë të biznesit, por nëpërmjet këtij financimi fillojmë programin tonë të cilin e kemi planifikuar që në vitin 2016 për eficiencën dhe investimet në rrjetin e shpërndarjes në zonën Tiranë-Durrës, në nënstacionet dhe në rrjetin

20 kV dhe 0,4 kV, si dhe në sistemin e automatizuar të kontrollit, i cili do të vazhdojë të shtrihet në rrjetin 20 kV gradualisht për të gjithë konsumatorët. Deri tani kemi qendrën dispeçer të sistemit SCADA dhe kemi të regjistruar në të 96 konsumatorë në nivelin 35 kV. Që të vazhdojmë me këtë na duhet të bëjmë ndërhyrje në rrjet, prandaj është bërë një shpërndarje e tillë. Në këtë sens na vjen në ndihmë, por nuk është e thënë që ne kemi pritur këto para për të vazhduar programin tonë.

Anastas Angjeli - Faleminderit!

Duke vlerësuar bashkëpunimin e shkëlqyer që qeveria shqiptare ka me KfW-në, mbështetjen që ajo ka dhënë ndër vite në projektet e energjisë, infrastrukturës dhe veçanërisht të ujësjellësve, si një financues, kreditor shumë serioz dhe që ka realizuar projekte shumë të suksesshme në përgjithësi në infrastrukturë, si dhe duke vlerësuar edhe ekspozitën tuaj për situatën energjetike në vend; duke vlerësuar përpjekjet e qeverisë që pavarësisht nga problematikat e kushteve të motit dhe të situatës hidrike në vend, ka marrë masa vazhdimisht me qëllim përballimin e kësaj situatë pa pasur nevojë për ndërprerje të energjisë për konsumatorin, për qytetarin për biznesin dhe për këdo, do të ishte mirë që Komisioni i Ekonomisë të ishte informuar për masat që keni marrë deri në fund të vitit.

Do t'ju lutesha të sillni në komision një informacion me shkrim duke pasur parasysh të gjitha këto që thatë për 6-mujorin e dytë, për masat që keni marrë për të përballuar vështirësitë e krijuara nga situata e motit dhe situata hidrike!

Faleminderit!

Kalojmë në votim!

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a., (agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW, Frankfurt am Main (KfW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”.

Kush është dakord në parim? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te votimi i nenit 1.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kush është dakord me nenin 2? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Faleminderit!

Urime dhe suksese në zbatimin e marrëveshjes!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti